

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Krimeve të Rënda, Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës parë**, përmes trupit gjykues të përbërë prej gjyqtarit - Aziz Shaqiri kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve Veli Kryeziu dhe Sahit Borovci – anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të akuzuarit H.R. nga ..., për shkak të veprës penale shtytja për kryerjen e vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 32 të Kodit penal të Republikës së Kosovës të cilin sipas autorizimit të mbrojtjes av. F.Y. nga ..., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Përgjithshme ( PTH – DKP ) PP.I.nr. 359/2013 të datës 24.01. të vitit 2014, të cilën e përfaqësoi prokurori i shtetit Shaban Spahiu, pas mbajtjes së shqyrtimit të fundit gjyqësor, verbal dhe publik më datën 24 nëntor të vitit 2016 mori dhe në prani të prokurorit të shtetit dhe të të akuzuarit me mbrojtësin e tij, e në mungesë të palës së dëmtuar, në të njëjtën ditë publikisht shpall këtë,

## A K T G J Y K I M

**I.** I akuzuari H.R. nga babai Q. dhe nëna K. – e lindur S., i lindur më ... në fshatin ..., Komuna e ..., me vendbanim në ..., rruga " ... ", nr. ..., posedues i telefonit mobil me SIM kartele ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve madhor, ka të kryer shkollën fillore tetëvjeçare, me gjendje të varfër ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij,

në kuptim të nenit 364 paragrafi 1. nënparagrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale ( në tekstin e mëtutjeshëm KPP ),

### **Lirohet nga akuza**

se më datën 26.12.2013 rreth orës 15,40 minuta ka nxitur –shtytur vëllain e tij tani të pandehurin M.R., në atë mënyrë që për derisa ka qenë bashkë me të pas një grindje me të pandehurin E.R., e ka fyer të njëjtin, i ka bërtitur të kthehet mbrapa, e pastaj i ka thënë vëllait të tij M. " hajde ja q.. nanen se qe ktu e kemi shancen" dhe në atë moment i shtytur nga këto fjalë i pandehuri M. mësyen me veturë ndaj të pandehurit E. për ta privuar nga jeta dhe me ç'rast e gode të pandehurin E. me veturë dhe i shkakton lëndim trupor,

-me çka kishte me kryer veprën penale shtytja nga neni 32 paragrafi 2 në kryerjen e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-s.

**II.** Shpenzimet e procedurë penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës në Prishtinë.

## A r s y e t i m

Organi kompetent i ndjekjes penale ka ngritur aktakuzë kundër të akuzuarve M.R. për shkak të veprës penale nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-s, E.R. për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-s kurse ndaj të akuzuarit H.R. për shkak të veprës penale nga neni 32 paragrafi 2 lidhur me nenin 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-s.

Ndaj të akuzuarit H.R. është veçuar procedura penale duke marr numër të ri lënda penale, kurse ndaj të dy tjerëve është vendosur në mënyrë meritore me vendime përkatëse.

Kryetari i trupit gjykues pas formimit të trupit gjykues lidhur me lëndën penale ndaj të akuzuarit H.R. ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor duke ftuar palët por edhe dëshmitarët dhe palën e dëmtuar.

Trupi gjykues në kuptim të nenit 7 të KPP-s me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë ka vlerësuar faktet relevante edhe kundër të akuzuarit H. edhe në favor të tij, duke jua mundësuar të njëjti me mbrojtësin e tij që gjatë zhvillimit të procedurës penale kundër lidhur me çështjen penale lëndore që të paraqesin të gjitha provat lidhur me vërtetimin e fakteve relevante të cilat janë në favor të të akuzuarit, kështu që pas dëgjimit të mbrojtjes së të akuzuarit në fjalë, të të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit E., R., të dëshmitares B.H. dhe S.R., me dëgjimin e CD- ve me numër 1, 2 dhe 3 së riprodhuar gjatë seancës të nxjerr nga kamerat afër vendit të ngjarjes sipas dispozitave ligjore, ka vërtetuar gjendjen faktike se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari në fjalë ka kryer veprën penale lëndore, andaj edhe i njëjti është liruar nga akuza lëndore.

Prokurori i shtetit gjatë fjalës përfundimtare mbeti në tërësi pranë akuzës lëndore duke i propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas dispozitave të Kodit penal.

Gjatë fjalës përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit deklaroi se me provat e administruara e duke pasur parasysh edhe CD-et e riprodhuara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetuar akuza ndaj të mbrojturit të tij, andaj edhe në mungesë të provave propozoi që i njëjti të lirohet nga përgjegjësia penale për veprën penale lëndore.

I akuzuari gjatë gjitha fazave të procedurës penale ka mohuar kryerjen e veprës penale duke dhënë shpjegime për ngjarjen se si është zhvilluar ditën kritike, ku ndër të tjera i pranishëm ka qenë edhe dëshmitari S.R. të cilin e ka familjar. Ka shtuar se me asnjë veprim të tij nuk e ka shtyer vëllain e tij që me veturën e tij ta privoj nga jeta të dëmtuarin të cilin e kanë pasur dhëndër dhe se motra e tij është ndarë nga i njëjti duke i lëndë dy fëmijë madhor.

Edhe dëshmitari S.R. në deklaratën e tij nuk ka theksuar se H. në ndonjë mënyrë ta ketë shtyer vëllain e tij M. për ta privuar nga jeta të dëmtuarin E.R..

Edhe dëshmitarja okulare B.H. të cilën e ka bashkëshorte jashtëmartesori i dëmtuari E. ka deklaruar se nuk e ka dëgjuar të akuzuarin që në ndonjë mënyrë ta ketë shtyer vëllain e tij për ta privuar nga jeta bashkëshortin e saj E..

Në tri CD me numrat 1, 2 dhe 3 të cilat janë riprodhuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor nuk është vërejtur nga trupi gjykues por edhe nga palët e pranishme në gjykatore që me ndonjë veprim të tij fizik i akuzuari ta ketë nxit apo shtyrë ndokënd e në këtë rast vëllain e tij M. që me veturë ta privoj ngajeta ndokënd e në këtë rast të

dëmtuarin E., e as që është dëgjuar ndonjë fjalë nga i akuzuari H. si shtytëse drejtuar vëllait të tij M. që ta privoj me veturën e tij nga jeta të dëmtuarin E..

Në rastin konkret deklarata e të dëmtuarit E. lidhur me atë se i akuzuari H. kinse e ka shtyer vëllain e tij M. që ta privoj nga jeta me veturë të dëmtuarin E., mbetet e vetme, me që me asnjë provë tjetër qoftë personale apo materiale duke përfshirë edhe deklaratën e dëshmitares B. për ndryshe bashkëshorte e të dëmtuarit nuk është vërtetuar asnjë fakt relevant përkitazi me ndonjë veprim inkriminues i të akuzuarit në drejtim të veprës penale për të cilën është akuzuar sipas aktit akuzues.

Andaj edhe gjykata në mungesë të provave të akuzuarin e ka liruar nga akuza lëndore.

Pasi që pala e dëmtuar ka deklaruar shprehimisht se ndaj të akuzuarit nuk ka ndonjë kërkesë pasurore juridike gjykata nuk ka vendosur në këtë drejtim, duke mos e trajtuar të dëmtuarin palë në këtë procedurë penale, në zbatim të përshtatshëm në këtë fazë të procedurës në kuptim të nenit 218 paragrafi 5 të KPP-s.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale ka vendosur në kuptim të nenit 454 paragrafi 1. të KPP-s.

Për arsyet e lartcekura u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJIJULAN – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**Divizioni Penal - PKR.nr. 230/2016, më datën 24 nëntor të vitit 2016**

**Sekretarja juridike,**  
Kadrije Zymeri

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Aziz Shaqiri, d.v.

**Udhëzim për mjetin juridik** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet **ankesë** në **Gjykatën e Apelit – Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm**, në afat prej pesëmbëdhjetë ( 15 ) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ankesa i dorëzohet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatë dhe palën kundërshtare.